

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Frosina Sylejmani anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.H. nga Prishtina, Rr.”... dhe B.B. nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurës NTSH “NN” Kompania e Sigurimit Fizik, me seli në Prizren, Rr.”...” nr.2013, të cilën e përfaqëson I.G. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.173/14, të datës 08.12.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 04.04.2018, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e paditurës NTSH “NN” Kompania e Sigurimit Fizik, me seli në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.173/14, i datës 08.12.2014, në pikën I dhe III, **VËRTETOHET**.

**II.** Pjesërisht aprovohet ankesa e të paditurës NTSH “NN” Kompania e Sigurimit Fizik, me seli në Prizren, ashtu që **NDRYSHOHET** pika V e dispozitivit të aktgjykimit C.nr.173/14, datë 08.12.2014, ndërsa gjykohet si vijon: Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**III.** Pika II dhe IV e dispozitivit të aktgjykimit C.nr.173/14, datë 08.12.2014, mbeten të pashqyrtuara.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.173/14, të datës 08.12.2014, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit B.H. dhe e ka obliguar të paditurën NTSH “NN” Kompania e Sigurimit Fizik, që paditësit t’ia paguajë pagën e pa paguar për muajin tetor, nëntor, dhjetor 2012 dhe pagën e muajit janar të vitit 2013, në shumë prej 600 euro, si dhe t’ia paguajë vlerën prej 10 % të pagës bruto në emër të kontributit pensional, për të gjithë muajt për të cilët nuk është bërë pagesa në bazë të kontratës së punës, në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit B.H. me të cilën ka kërkuar që të kompensohet për punën jashtë orarit të punës, si të pa bazuar. Ndërsa në pikën III të dispozitivit të aktgjykimin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit B.B. dhe e ka obliguar të paditurën NTSH “NN” Kompania e Sigurimit Fizik, që paditësit t’ia paguajë pagën e pa paguar për muajin nëntor, dhjetor 2012 dhe pagën e muajit janar, shkurt dhe mars të vitit 2013, në shumë prej 750 euro, si dhe t’ia paguajë vlerën prej 10 % të pagës bruto në emër të kontributit pensional, për të gjithë muajt për të cilët nuk është bërë pagesa në bazë të kontratës së punës, në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit B.B. me të cilën ka kërkuar që të kompensohet për punën jashtë orarit të punës, si të pa bazuar, ndërsa në pikën V të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësve t’i kompensojë shpenzimet e procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës ashtu që aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësit kanë paraqitur përgjigje në ankesë, përmes së cilës kanë propozuar që në tërësi të refuzohet si e pa bazuar ankesa e palës së paditur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është **e pabazuar**, në lidhje me pikën I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ndërsa për pikën V të dispozitivit të aktgjykimit është **e bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 20.02.2014, në Gjykatën Themelore në Prizren, paditësit kanë parshtruar padi, kundër të paditurit, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësve, t'ia kompensojë pagat e papaguara për periudhën e cekur në pikën I dhe II të dispozitivit të atakuar, si dhe t'i kompensojë punën e realizuar jashtë orarit të punës, së bashku me shpenzimet procedurale, më gjerësisht sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.173/14, të datës 08.12.2014,, me të cilën pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas administrimit të provave në shqyrtimin kryesor dhe atë: kontratën e punës në kohë të caktuar, të datës 01.04.2012, të lidhur në mes paditësit B.H. dhe të paditurës, kontratën e punës të datës 01.01.2012, transaksionin bankar për paditësin B.H., për periudhën 01.01.2012, deri më 20.12.2011, të lëshuar nga TEB Banka, si dhe për vitin 2013 nga data 01.01.2013, deri më 31.12.2013, marrëveshjen e lidhur në mes punëdhënësit-të paditurit dhe punëmarrësit-paditësit B.B. të datës 26.03.2013, kontratën e punës së datës 07.07.2012, të lidhur në mes paditësit të dytë dhe të paditurës, pasqyrën e trustit pensional të datës 14.01.2014, transaksionin bankar nga TEB Bank për paditësin e dytë, nga data 28.05.2012, deri me 31.12.2012, nga data 01.01.2013, deri me datë 31.12.2013, kontratën kornizë për sigurimin fizik të depos së barnave Ref.nr.7130/10/547/221, të datës 10.12.2010, pasqyrën e trustit pensional për paditësin e parë për periudhën 31.12.2001, deri me datë 31.12.2013 etj, përmes të cilave sipas gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar fakti paditësit kanë themeluar marrëdhënien e punës me të paditurën, ndërsa për muajt kontestues të njëjtit nuk i kanë realizuar pagat mujore sipas kontratës së punës, si dhe të njëjtëve e paditura nuk i ka paguar kontributin në Trustin Pensional për këta muaj, edhe pse e ka pasur detyrim ligjor një gjë të tillë, për çka edhe kjo gjykatë ka ardhur në përfundim dhe ka vërtetuar se ekziston detyrimi juridik civil i të paditurit ndaj paditësve, për kompensimin e të ardhurave personale, të cekura në pikën I dhe III të dispozitivit të

aktgjykimit të atakuar. Ndërsa gjykata e shkallës së parë, pjesën e kërkesëpadisë së paditësve me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura të paguajë paditësve kompensimin për punën e bërë jashtë orarit të punës, e ka refuzuar në mungesë të provave.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 181.1 pika b) e LPK-së, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën I dhe III është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Në lidhje me mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë, në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, e që i referohet detyrimit të paditurit që paditësve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës, një qëndrim të tillë juridik nuk mund ta pranojë Gjykata e Apelit. Kjo për faktin se në mënyrën se si ka vendosur gjykata e shkallës së parë, këtë pjesë të dispozitivit të aktgjykimit e bënë plotësisht të paqartë dhe të pa përmbarueshëm. Në lidhje me këtë, referuar nenit 463 paragrafi 1 të LPK-së, për pagimin e shpenzimeve të procedurës gjykata vendos vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën. Andaj, me rastin e vendosjes gjykata e shkallës së parë është dashur që në mënyrë specifike të cek lartësinë e shpenzimeve që është dashur pala e paditur t'ia paguajë palës paditëse, e jo në mënyrë paushalle vetëm të thuhet se pala e paditur obligohet t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës. Si rrjedhojë, gjykata e shkallës së dytë vendosi që ta ndryshojë pikën V të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar dhe të gjykojë që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale, pasi që referuar shkresave të lëndës paditësit para gjykatës së shkallës së parë, nuk kanë dorëzuar asnjë provë materiale me të cilën do të vërtetoheshin shpenzimet e bëra dhe lartësia e tyre.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që ka rezultuar se nuk ka pasur pretendime ankimore nga asnjëra palë ndërgjyqëse në raport me vendosjen e gjykatës së shkallës së parë për pikën II dhe IV të dispozitivit

të aktgjykimit të atakuar, andaj edhe këto pjesë të dispozitivit të aktgjykimit kanë mbetur të pashqyrtuara.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 dhe 201 parag.1 pika (c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.596/15, datë 04.04.2018**

**Kryetari i kolegjit,  
Lumni Sallauka**